



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-065

Prishtinë, më 15 korrik 2016, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C - 301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 KORRIK 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Sali Morina, Slavko Simiq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Butyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,
Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe
Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Para se të procedohet me rendin e ditës të kësaj mbledhje, kryetari fjalën ia dha nënkryetarit të Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, në cilësinë e kryetarit të Grupit të Miqësisë Kosovë - Francë, tha se e dënojmë sulmin e rëndë terroristë që ndodhi mbrëmë në Nicë të Francës. Në këtë sulm të tmerrshëm u vranë më shumë se 80 persona, ndajmë dhembje, pikëllim e bashkëndejmë me familjet e viktimave, me popullin francez dhe shtetin Francës.

Kryesia e Kuvendit, në shenjë nderimi për viktimat që e humbën jetën nga ky sulm, mbajti një minutë heshtje.

Pastaj, Kryesia, me propozimin e Kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 4 korrik 2016.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës:

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishëm në mbledhje, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 4 gusht 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-106 për Ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës,*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-104 për Ratifikimin e Marrëveshjes Përkritazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-105 për Mbrojtjen e Fëmijës,*

8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje,*
9. *Shqyrtimi i Raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015,*
10. *Shqyrtimi i Raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015,*
11. *Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje.*

Gjithashtu, Kryesia pasi diskutoi lidhur me pikën e propozuar të rendit të ditës-Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohet nga Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që ta rishqyrtojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandim.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. *Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor që Qeveria e Republikës së Kosovës ta hartojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-205*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Komisionit të lartcekur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të deklarohej lidhur me kërkesën e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-205.

2. *Kërkesa e Grupit të deputetëve të Kuvendit për organizimin e një debati profesional-shkencor mes komisionit shtetëror për Demarkacion dhe grupit të njohësve profesionist për diskutim dhe ballafaqim faktesh për çështjen e Demarkacionit Kosovë-Mali i Zi*

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan: Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Xhavit Haliti, Sllobodan Petroviq, Fikrim Damka, Adem Grabovci, Sali Morina dhe Slavko Simiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartcekur të Grupit prej 24 deputetëve të Kuvendit, unanimisht,

Vendosi:

1. Tryeza për debat profesional-shkencor mes Komisionit Shtetëror për Demarkacion dhe grupit të njohësve profesionistë për diskutim dhe ballafaqim faktesh për çështjen e Demarkacionit Kosovë - Mali i Zi do të organizohet më 3 gusht 2016, në orën 10:00, në ndërtesën e Kuvendit, salla N-409.

2. Të ftohen grupet parlamentare të Kuvendit, përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, ekspertët e propozuar nga grupi prej 24 deputetëve të Kuvendit, si dhe mediat për të marrë pjesë në Tryezë.

Të ndryshme:

1. Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit me Raportin e Auditimit për Pasqyrat vjetore Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015, i cili i ishte adresuar Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike. Ai, pas shqyrtimit nga Komisioni, do të procedohet për shqyrtim të mëtejme në Kuvend.

2. Propozimi për kompensimin e të punësuarve në Kuvendin e Republikës

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, vendosi që të punësuarve në Kuvendin e Republikës së Kosovës për angazhim të shtuar jashtë orarit të punës në mbështetje të trupave punues të Kuvendit: Kryesisë së Kuvendit, Seancës plenare dhe komisioneve parlamentare për realizimin e programit të punës së Kuvendit, t'u bëhet kompensimi në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro.

3. Draft rregullore për mbrojtje nga zjarri

Draft rregullorja për mbrojtje nga zjarri u shty përmbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

4. Shërbimet e bufesë në ndërtesën e Kuvendit.

Nënkryetarja e Kuvendit znj. Aida Dërguti e ngriti çështjen e shërbimeve në byfenë e Kuvendit. Ajo tha se ka dallim të madh ndërmjet çmimeve reale dhe atyre të paraqitura në kontratë nga ofruesi i shërbimeve, kompania "Shqiponja".

Kryetari kërkoi nga Administrata e Kuvendit që ta shqyrtohet ofertën-kontratën me Kompaninë "Shqiponja" dhe ta përgatitë një informatë të hollësishme për Kryesinë e Kuvendit lidhur me këtë çështje.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale